„HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.
893
31.03 2023
PRIZREN

# Vlerësimi i Bordit të NP-ve – 2022

**NP: K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR" SH.A - PRIZREN**
**Koha: 01.01.2022 - 31.12.2022**
**Data:**

| | Vetë-vlerësimi i Bordit | Komenti |
|---|---|---|
| **A. Aktivitetet e Bordit** | | |
| 1. Kur ka filluar aktivitetin Bordi, gjegjësisht kur është mbajtur mbledhja e pare e Bordit? | Me 25.08.2022 | |
| 2. Sa anëtare ka Bordi i Drejtoreve duke përfshirë edhe Kryeshefin Ekzekutiv te NP? | Bordi i drejtoreve duke përfshirë edhe KE, ka 7 anëtarë. | |
| 3. Sa mbledhje ka mbajtur Bordi i Drejtoreve gjate këtij viti? | Bordi i Drejtoreve gjatë vitit 2022 ka mbajtur gjithsej 11 takime. Sipas procesverbaleve takimet janë mbajtur në këto data:<br>25.08.2022<br>30.08.2022<br>16.09.2022<br>27.09.2022<br>17.10.2022<br>28.10.2022<br>14.11.2022-MPVA<br>30.11.2022<br>16.12.2022<br>22.12.2022<br>30.12.2022 | |
| 4. A është takuar Bordi aq shpesh sa janë paraqitur kërkesat për çështjet e NP-ve? | Po, Bordi ka mbajtur të gjitha takimet me kërkesat e NP! | |
| 5. A kanë punuar anëtarët e Bordit në mënyrë efikase si ekip, për t'i zgjidhur në mënyrë të kënaqshme mospajtimet? | Puna e BtD ka qenë ekipore, efikasiteti në punë nuk ka munguar. Për te gjitha temat e diskutuara Bordi ka arritur konsensus te plotë. | |
| 6. Përveç prezencës së ZKE-së në takimet e Bordit, a ka pasur ndërlidhje të mjaftueshme në mes të Bordit dhe ekipit të | Po, ndërlidhja mes Bordit dhe ekipit të menaxhmentit ka qenë e kënaqshme! | |

| | | |
|---|---|---|
| menaxhmentit ekzekutiv? | | |
| 7. A ka patur konflikte te kompetencave ne mes te Bordit dhe Menaxhmentit? | Jo, nuk ka pasur! | |
| 8. Cilat rreziqe për të ardhmen dhe performancën e ndërmarrjes i ka diskutuar Bordi dhe çka ka vendosur Bordi? | - Humbjet e ujit!<br>- Bordi ka urdhëruar që deri në fund të vitit 2023 të gjithë ujëmatësat e prodhimit dhe zonal të vendosen të rinj aty ku nuk ka ose të funksionalizohen aty ku nuk punojnë!<br>- Borxhet e këqija,<br>- Bordi ka kërkuar mendim – sugjerim nga aksionari lidhur me mundësinë ligjore që Kompanisë ti lejohet të bëjë parashkrimin e tyre.<br>- Pezullimi i licencës për Mamushën,<br>- Bordi ka shprehë shqetësimin e thellë Kryeshefit me kërkesën që me urgjencë, përgjegjësi dhe përkushtim të punohet për rikthim sa ma të shpejtë të licencës prej ARRU-së. | |
| 9. A i ka miratuar Bordi, Kodin e Etikes dhe Qeverisjen Korporative? | Kodi Etikes ka qene i miratuar nga BiD në vitin 2010 i plotësuar dhe i ndryshuar pastaj nga NJPMNP ne vitin 2014. Kodi Etikes na është dërguar nga Kompania me fillimin e aktivitetit si BiD ne HRJ. | |
| 10. A i kane nenshkruar zotimet per respektimin e Kodit dhe Ligjit te gjithe anetaret e BtD? | Po, nga secili anëtarë i BtD është nënshkruar Zotimi për respektimin dhe zbatimin e Kodit te Etikes dhe Qeverisjes Korporative bazuar ne Ligjin për NP, Nr. 03/L-087 nenin 35.3. | |
| 11. A i'u ka referuar Bordi kodit të etikës dhe qeverisjes korporative të ndërmarrjes? A janë paraqitur çështje të cilat nuk kanë qenë në kod? Çfarë veprime ka marrë Bordi? | Bordi qdo herë i është referuar Kodit të etikës dhe ligjit për ndërmarrjet publike Nr.03/L-087! | |
| 12. A ka pranuar Bordi ndonje koment nga Aksionari- NJPMNP mbi rishikimin e ndonje vendimi? Nese po, a i ka shqyrtuar Bordi komentet dhe a eshte njoftuar aksionari-NJPMNP? | Jo, nuk kemi pranuar asnjë koment për rishikim nga NJMNP! | |

| | | |
|---|---|---|
| 13. A ka miratuar Bordi i Drejtoreve Planin e Biznesit para 31 Tetorit? | Po, Plan Biznesi është miratuar me 28.10.2022 | |
| 14. A ka miratuar Bordi i Drejtoreve raportin mbi kenaqesine e konsumatorit sipas nenit 28 te Ligjit? | Po, ky raport është miratuar nga ish Bordi i përkohshëm me dt. 31.03.2022. Ndërsa për vitin 2022 u miratua në mbledhjen e bordit me 31.03.2023 | |
| 15. A ka miratuar Bordi i Drejtoreve raportet tremujore dhe vjetore sipas nenit 31 te Ligjit? | Po, Bordi i drejtorëve i ka miratuar raportet tremujore, në afatet ligjore përkatësisht sipas nenit 31 te Nr.03/L-087! | |
| 16. A ka respektuar Bordi i Drejtoreve vendimin e Qeverise mbi lartesine e kompensimit te Bordit te Drejtoreve? | PO, e ka respektuar në plotëni! | |
| 17. Në këndvështrim, çfarë ka bërë Bordi që nuk është dashur të bëjë? | Te gjitha aktivitetet dhe vendimet e BtD janë bazuar ne Kodin e Etikës dhe Ligjin për NP Nr.03/L-087. | |
| **B. Komitetet e Bordit** | | |
| 1. Cilat Komitete të Bordit kanë qenë aktive gjatë kësaj periudhe? *(listojë ato)* | Komisioni i Auditimit! (KA) | |
| 2. Kur Aksionari ka formuar Komisionin e Auditimit? | 15.08.2022 | |
| 3. Kur ishte mbledhja e pare e Komitetit te Auditimit? | 29.08.2022 | |
| 4. A mbajti mbledhje Komiteti i Auditimit tri dite para cdo mbledhje te Bordit te Drejtoreve? | Po, rregullisht, se paku 3 deri 5 dite para mbledhjes se Bordit të Drejtorëve | |
| 5. A shqyrtoi ne mbledhjet e veta Komisioni i Auditimit te gjitha raportet qe kerkohen me Ligj? | Gjate vitit 2022 KA ka mbajtur pesë mbledhje te KA dhe janë shqyrtuar të gjitha raportet që kërkohen me ligj. | |
| 6. A ka miratuar Komiteti i Auditimit Deklaraten mbi Politiken e Kompensimit? | Është në procedurë të miratimit pasi paraprakisht i është dërguar NJPMNP për komentin, jemi ne pritje te komentit te NJPMNP lidhur me | |

| | | |
|---|---|---|
| | Deklaratën mbi Politiken e Kompensimit. | |
| 7. Cili Komitet i Bordit ka kontribuar më së shumti për të përmirësuar performancën në këtë periudhë? | Kompania ka vetëm Komitetin e Auditimit. (Nuk ka komitete tjera) | |
| 8. Cili Komitet i Bordit mund të shpërndahet pa pasur ndonjë humbje? | Kompania ka vetëm Komitetin e Auditimit. Eshte obligim ligjor.<br>(Nuk ka komitete tjera) | |
| 9. Cilat rekomandime të rëndësishme janë formuluar nga komitetet dhe i janë referuar Bordit për miratim? | Rekomandimet kryesore te KA, qe i janë referuar Bordit për miratim:<br>*(Disa nga raportet te cilat janë shqyrtuar dhe dërguar BD për miratim)*<br><br>1. Raportit i ZKA-se dhe Planit te Veprimit për adresimin e gjetjeve dhe rekomandimeve për auditimin e vitit 2021.<br>2. Raporti TM2-2022.<br>3. Raporti Korrik 2022.<br>4. Raportit Gusht 2022,<br>5. Plani i veprimit te Auditorit te Brendshëm për vitin 2022,<br>6. Raportit Shtator 2022<br>7. Raportit TM3 2022,<br>8. Draft Plan Biznesit 2023-2025,<br>9. Raporti Tetor 2022<br>10. Shqyrtimi i Skemës se re Organizative dhe koeficienteve sipas udhezuesit te KNM-se.<br>11. Shqyrtimi i planit strategjik të auditimit,<br>12. Shqyrtimi i planit vjetor të auditimit<br>Raporti Nentor 2022 | |
| **C. Veprimet** | | |
| 1. Cilat janë veçoritë kryesore operative që e brengosin Bordin dhe çfarë hapa ka ndërmarrë Bordi deri më sot për t'i adresuar këto çështje? | Humbjet e ujit, furnizimi më i mirë në zonat me probleme në furnizim, pezullimi i liçencës së Mamushës, dhe të gjeturat e auditorit, janë disa nga veçoritë brengosëse për Bordin. Për të gjitha këto bordi ka dhënë sugjerime dhe ka marrë vendime me të cilat është njoftuar aksionari, përmes vendimeve tona! | |
| 2. Çfarë ka bërë Bordi për të | Në çdo mbledhje të Bordit janë trajtuar | |

| | | |
|---|---|---|
| përmirësuar kualitetin e shërbimeve të ndërmarrjes? | shërbimet që ofron ndërmarrja dhe janë dhënë shumë sugjerime dhe janë marr disa vendime.<br>Ja disa nga këto:<br>- Frunizimi me ujë të jetë më i ne mirë se deri më tani.<br>- Në disa lokalitet ka ankesa për furnizimim jo të rregullt me ujë të pijes,<br>- Në disa lokalitete është shpërndarë rrjeti dhe qytetarët ende nuk furnizohen me ujë rregullisht. Duhet të merren masa urgjente që të evitohen problemet e tilla, dhe ujë i bollshëm e me kualitet të rrjedh në ata gypa.<br>- Rrugët e dëmtuara pas sanimit të defekteve të rikthehen në gjendje të më parshme më shpejtë dhe më me kualitet!<br>- Të merren veprime të nevojshme që konsumatorët të cilët banojnë në katet e larta të ndërtesave të mos vuajnë nga presioni i pamjaftueshëm i ujit. | |
| 3. A ka patur intervenime individuale te anetareve te Bordit? | Jo | |
| 4. A ka patur tentime per perzierje te Bordit ne mikromenaxhim, ne rekrutim te personelit, apo ne prokurim? | Jo, nuk ka pasur! | |
| 5. Çfarë ankesa nga jashtë i janë referuar Bordit dhe si i ka zgjedhur Bordi ato? | Nga jashtë kompanisë nuk jemi të njoftuar se ka pasur ankesa për Bord ndërsa nga brenda kompanisë ka pasur ankesa te menaxherëve te departamentit teknik , për konsumator dhe Impiantit, e të cilat janë shqyrtuar dhe trajtuar! | |
| 6. A i ka konsideruar (shqyrtuar) Bordi ndryshimet në faktorët e jashtëm të cilat mund të përmirësojnë performancën e ndërmarrjes? | - Bordi ka iniciuar çështjen e pronësisë së objektit qendror dhe ka filluar procesin e rishqyrtimit juridik dhe | |

| | | |
|---|---|---|
| Dhe çfarë hapa ka ndërmarrë Bordi për t'i përmirësuar këto ndryshime? | administrativ të çështjes së pronësisë, pasi aktualisht objekti në fjalë nuk është pronë e kompanisë sonë dhe Kompania ka statusin e qeraxhiut në shtëpinë e tij!<br>- Mbledhja e dëshmive dhe rishqyrtimi i lëndëve në Gjykatë si palë e paditur nga ana e punëtorëve si dhe kompenzimet nga ana e konsumatorëve. | |
| **D. Baza e aseteve fizike** | | |
| 1. A janë kërkuar më shumë investime kapitale dhe nëse "po":<br>(a) Për çka (në përgjithësi –dhe sipas prioriteteve);<br>(b) Sa (përafërsisht);<br>(c) Kush do të paguajë për këto investime? | Bordi mendon se Kompania posedon mjete të mjaftueshme për investimet kapitale vetanake, por ka kërkuar shfrytëzim më racional dhe më të efektshëm të tyre! | |
| 2. Cilat ndryshime teknologjike mund të miratohen për të përmirësuar shërbimet dhe performancën në ndërmarrje? | - Aplikimi i sistemit SMART për leximin e ujëmatësve prodhues, zonal dhe atyre shpenzues (të konsumatorëve)!<br>- Paisjet akustike detektor për detektim të rrjedhjeve të ujit | |
| **E. Kapitali njerëzor** | Bazuar në raportet që ka Bordi dhe rezultateve të punës që janë prezantuar, punonjësit, punojnë me efikasitet të mirë te punës<br>Bordi ka vërejt se është i nevojshëm një angazhim më i madh tek lexuesit e ujëmatësave si dhe shpërndarja e faturave me kohë, e sidomos angazhim më i mirë i kontrollës-inspektorëve për zvoglimin e humbjeve të ujit. | |
| 1. A janë duke punuar punonjësit me efikasitet maksimal? Nëse jo, cilat janë fushat dhe arsyet e deficitit? | | |
| 2. A bazohet pasuria njerëzore në terma të dijes, përvojës dhe aftësive? | Po. Gërshetimi i këtyre tre indikatoreve, pa dyshim, sjell rezultate. | |
| 3. A e ka vlerësuar Bordi performancën e anëtarëve të | Është në Proces! | |

| | | |
|---|---|---|
| ekipit të menaxhmentit? Në përgjithësi cilat ishin konkluzionet e tij? | | |
| 4. A i ka shqyrtuar Bordi – ose a i ka inicuar – ndryshimet në personel me qëllim që të përmirësojë performancën? | Sa i përket personelit i cili i përgjigjet Bordi (Kryeshefi, ZKF, Sekretarja, dhe Auditori i brendshëm), bordi mendon se deri tani janë në nivel optimal të kryerjes së detyrës, sa që nuk ka pas nevojë për inicim për ndryshime.<br>Në kuadër të rishqyrtimit dhe miratimit të organogramit, bordi ka vërejtur disa diskrepanca në personel të cilat i ka vlerësuar si jo efikase, jo të kohës, apo jo të nevojshme, dhe në ato vende ka modifikuar organogramin me të cilat modifikime mendojmë se kompania do të performoj më mirë dhe do të përmirësohen performancat! | |
| 5. A është i kënaqur Bordi që ndërmarrja është konkurrente në terma të politikave të personelit të saj duke përfshirë shpërblimet? | Në përgjithësi Po.<br>Politikat e personelit, duke përfshirë politikën e shpërblimeve, gjithmone ka hapsirë për permirësime dhe korigjime. | |
| **F. Financat** | | |
| 1. A është secili Drejtor në gjendje t'i lexojë dhe interpretojë pasqyrat financiare të ndërmarrjes dhe raportet e auditorëve të jashtëm? Cilat janë fushat me vështirësi? | Po! Unë si kryesues mendoj se të gjithë anëtarët e Bordit janë në gjendje të lexojnë, ti kuptojnë dhe ti interpretojnë pasqyrat financiare! | |
| 2. A është Bordi i kënaqur me performancën financiare në lidhje me: (a) buxhetin vjetor; dhe (b) ambientin biznesor. | PO, relativisht i kënaqur!<br>Gjithmone ka hapsirë për permirësime dhe korigjime, të cilat mund të merren parasysh gjate revidimit të Blanit të Biznesit. | |
| 3. A planifikon Bordi të ndalojë kërkesat për subvencione dhe/ose grante kapitale në Qeveri? | Nuk ka pasur kërkesa të tilla, | |
| 4. A është e duhur strukura tarifore e ndërmarrjes për vitin e ardhshëm dhe më tutje? Cilat | Medojmë, se struktura tarifore është e | |

| | | |
|---|---|---|
| ndryshime (nëse ka ndonjë) do t'i rekomandojë Bordi? | duhur dhe aktualisht nuk ka nevojë për ndryshim! | |
| 5. A e ka ndërmarrja kapitalin adekuat të punës? Nëse "jo" radhitni vendimet e marra nga Bordi për të zgjidhur këtë problem. | Ndërmarrja ka kapital adekuat dhe optimal për të realizuar objektivat e parapara në Biznes plan! | |
| **G. Pronësia** | Struktura e tanishme e pronësisë, mund të ndikojë, dhe mund të jetë pengesë për performancë optimale. BD ka pas takime me të gjitha institucionet me qëllim të zgjidhjes afatgjate të problemit të zyrave qendrore të administratës.<br>Si pengesë konkrete e shohim çështjen e pronësisë së objektit, me të cilën kemi filluar të merremi! | |
| 1. A e konsideron Bordi strukturën e tanishme të pronësisë të jetë pengesë për performancën optimale? Nëse "po", çfarë propozime ka bërë Bordi për ta zgjidhur këtë? | | |
| 2. A i ka shqyrtuar Bordi pengesat e investitorëve në sektorin privat dhe/ose operatorëve? Cilat janë ato pengesa? | JO, nuk ka pasur të tilla kërkesa! | |
| 3. A ka bërë Bordi ndonjë propozim për të inkurajuar involvimin e sektorit privat; dhe në çfarë mënyra? | JO, aktualisht nuk e shohim të nevojshme! | |
| 4. A e ka shqyrtuar Bordi bashkimin e mundshëm ose përvetësimet? Nëse është përballur me këtë opsion, përmbledhi pikëpamjet e Bordit. | JO | |
| 5. A e konsideron Bordi që aksionarët e tanishëm janë të kënaqur me performancën e Bordit? Çfarë shqetësime mund të kenë aksionarët? | PO | |
| 6. A ka pasur Bordi ndërlidhje të mjaftueshme me aksionarët që të jetë në gjendje t'i matë pikëpamjet e aksionarëve për politikat e tanishme biznesore? Nëse "jo", pse? | PO | |
| **H. Planifikimi** | | |
| 1. A është Bordi i kënaqur me | Bordi është i kënaqur me planifikimet , | |

| | | |
|---|---|---|
| procesin e planifikimit të biznesit dhe çfarë përmirësime mund të bëhen? | por duhet të shiqohet mundësia e zgjerimit të rrjetit, integrimi i zonave rurale me burimet vetanake për rritjen e numrit të konsumatorëve, si dhe rritjen e të hyrave me inkasim për shërbimet e ofruara! Gjithmone ka hapsire per permiresime dhe korigjime, të cilat mundë të merren parasysh gjatë revidimit të Blanit të Biznesit. | |
| 2. A është përgatitur plani i biznesit me kohë? | PO | |
| 3. A është aprovuar plani i biznesit nga ana e Bordit deri më 31 Tetor? | PO | |
| 4. Çfarë plane të veprimeve janë ndërmarrë nga Bordi në përcaktimin e planit të tanishëm biznesor? | Përkundër që plani aktual biznesor është miratuar 2 muaj pas ardhjes në detyrë të këtij bordi, Bordi ka dhënë kontribut të duhur në përpilimin e Planit të Biznesit. | |
| 5. A bën Bordi planifikime afat-gjata? | Po, përmes planit të biznesit! | |
| 6. Cilat çështje e vështirësojnë planifikimin dhe çfarë ka bërë Bordi për t'i adresuar këto? | Plani i menaxhimit të aseteve, si parakusht i rëndësishëm për planifikim sa më real. | |
| 7. A është i kënaqur Bordi me procesin e buxhetimit? Cilat përmirësime mund të bëhen? | Po | |
| 8. A janë me kohë në dispozicion të Bordit raportet tremujore të performancës? | PO | |
| 9. A e krahasojnë raportet tremujore performancën aktuale me buxhetin dhe a i sqarojnë mospërputhjet? | PO | |
| 10. A ka përfitime materiale te anëtareve përveç atyre qe Qeveria ka lejuar me Vendim? | JO | |
| 11. A ka konflikt te interesit ne kompani nga anëtaret e Bordit? | JO | |
| **I.Vleresimi i Pergjithshem i Bordit** | | |
| 1.Pershkrimi i Vleresimit te Pergjithshem | Bordi ka bërë një punë të shkëlqyer. Përkushtimi i bordit ka qenë maksimal. | |

| | | |
|---|---|---|
| | 11 mbledhje të rregullta të bordit për vetëm 5 muaj, janë një tregues në vete i përkushtimit të tij! | |
| 2. Vleresimi sipas notave duke filluar nga 1 deri ne 5 | 5 (pesë) | |
| Nëshkruar nga:<br><br>Kryesuesi:<br><br>Sekretari/ja i/e Kompanisë:<br><br>Më datë: 31.03.2023 | | |